




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024**



Prishtinë, 2024

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL
TË KOSOVËS

Qershor 2024

Kryesuesi Hajdaraj priti në takim ekipin e Misionit të Bankës Botërore

Prishtinë, 4 qershor 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, së bashku me Zëvendëskryesuesen Jehona Grantolli, priti në takim ekipin e përfaqësuesve të Misionit të Bankës Botërore, të kryesuar nga Specialisti i Lartë i Sektorit Publik, Klaus Decker dhe Menaxherin e Programit të Zyrës së Bashkimit Evropian, Nicola Scaramuzzo.

Takimi i Kryesuesit të KPK-së me përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore është realizuar në kuadër të zbatimit të Projektit "EU4 për sundimin e ligjit: Mbështetja e politikave të bazuara në dëshmi për performancën e sistemit të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor".



Me këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj dhe përfaqësuesit e Bankës Botërore diskutuan për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara në përputhje me procesin e integritetit dhe anëtarësimit të Kosovës në BE, me anë të të cilave synohet përmirësimi i njohurive dhe i të dhënave të performancës së sistemit prokurorial.

Z.Hajdaraj dhe z.Decker janë pajtuar për hapat e ardhshëm të bashkëpunimit, në mënyrë që fillimisht të mundësohet zbatimi i anketës së drejtësisë, të sigurohet mbështetja e mundshme për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit dhe të bëhet identifikimi i fushave të tjera me interes për shkëmbimin e njohurive.





Shqyrtohet kërkesa buxhetore për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2026-2027

Prishtinë, 4 qershor 2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës, në të cilin përveç anëtarëve të këtij komisioni, mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi dhe udhëheqëset e njësive për buxhet dhe financa në SKPK.



Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i kërkesës buxhetore për vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme për 2026-2027 për të gjitha programet buxhetore të KPK-së dhe kategoritë ekonomike të buxhetit.

Në takimin e sotëm u diskutua për planifikimet buxhetore, sidomos për nevojat për staf dhe buxhetin shtesë për kategorinë e pagave, mëditjeve dhe mallrave, si dhe shërbimeve, sipas kërkesave të prokurorive dhe njësive të tjera përgjegjëse të KPK-së.

Pas shqyrtimit të kërkesës buxhetore, propozimeve për ndryshime dhe plotësime, e njëjta do të rekomandohet për aprovim në Këshillin Prokurorial të Kosovës.



Lansohet uebportali i ri i sistemit prokurorial

Prishtinë, 5 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës organizoi ceremoninë e lansimit të uebportalit të ri të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, dizajnimin dhe zhvillimin i të cilit e ka mundësuar Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, konkretisht Projekti "Mbështetje për përpjekjet kundër korrupsionit, SAEK III, përmes ndihmës së Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Suedisë.

Në ceremoninë e sotme përuruese morën pjesë krerët institucionalë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit, përfaqësuesit e UNDP-së, të kryesuar nga Përfaqësuesi Rezident, Nuno Queiros, përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë, të partnerëve ndërkombëtarë, të shoqërisë civile dhe mediave, si dhe zyrtarë të sistemit prokurorial.

“Ky burim bazik i informacionit publik do të jetë në shërbim të mediave, të shoqërisë civile dhe të të gjithë qytetarëve të vendit”, ka theksuar më këtë rast Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, duke potencuar më tej se KPK-ja është e përkushtuar për të avancuar dhe për të fuqizuar informimin dhe komunikimin publik, të cilat i konsideron pjesë integrale të zbatimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.





U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, nënvizoi në fjalën e tij të rastit se lansimi i uebportalit të ri është një dritare e informacionit që do të jetë një mënyrë e mirë që secili qytetar, organizatë e shoqërisë civile apo media të ketë informacione me të plota dhe në kohë reale, në mënyrë që imazhi i Prokurorit të Shtetit dhe sistemit prokurorial të avancohet, siç është duke u avancuar çdo ditë.

Përfaqësuesi i UNDP-së, Nuno Queiros, ka thënë se avancimi i kapaciteteve komunikuese është një mundësi e mirë për sistemin prokurorial që të realizojë krijimin e hapësirës së informimit publik zyrtar përmes këtij uebportali, për të cilin kemi ofruar mbështetjen tonë.

Drejtori i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, tha se çdo ditë po punohet që të ndërtojmë një qasje të re të informimit dhe komunikimit, që e konsiderojmë detyrim dhe nevojë të kohës dhe administrata e sistemit prokurorial do t'i kushtojë rëndësi të madhe informimit të opinionit publik, duke komunikuar në mënyrë proaktive me publikun, mediat dhe qytetarët e vendit tonë.

Në përmbyllje të kësaj ceremonie është prezantuar uebportali i ri nga Udhëheqësi i DTI-së në SKPK, Nexhat Haziri, i cili ka shpalosur risitë dhe përparësitë që krijon ky portal në aspektin e lehtësimit të marrjes së informacionit nga palët e interesuara.







Kryesuesi Hajdaraj dhe Drejtoresha e INL-së në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, Tamara Greig, diskutojnë për ngritjen e bashkëpunimit

Prishtinë, 5 qershor 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim Drejtoreshën e INL-së në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, Tamara Greig.

Kryesuesi Hajdaraj e falënderoi Drejtoreshën e INL-së për mbështetjen e sistemit prokurorial përmes Programit për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, si dhe e njoftoi atë për aktivitetet e zhvilluara dhe trajtimin e sfidave aktuale të sistemit prokurorial.



Gjatë takimit, Hajdaraj-Greig janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen e bashkëpunimit dhe nevojat e sistemit prokurorial dhe vazhdimi i programit strategjik për luftimin e drogave sintetike, si dhe nevojën e ofrimit të ekspertizës së INL-së që ka të bëjë me përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Nga ana tjetër, Drejtoresha e INL-së, Greig, falënderoi Kryesuesin Hajdaraj për pritjen, duke theksuar përkushtimin e mëtjeshëm të INL-së për të ofruar ndihmë për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan gjatë diskutimeve që patën që të ketë takime më të shpeshta në mes tyre për t'i zbatuar objektivat strategjikë të sistemit prokurorial.

INL, përmes Programit të Departamentit të Drejtësisë për Ndihmë, Trajnim dhe Zhvillim Prokurorial Jashtë Vendit (OPDAT), mbështet trajnimin e prokurorëve, ofron ndihmë teknike, ndihmon në hartimin e legjislacionit, bën analiza ligjore dhe kontribuon në edukimin arsimor pasuniversitar, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe të drejtësisë penale në Kosovë.



Përfaqësuesit e sistemit prokurorial marrin pjesë në publikimin e Raportit të OSBE-së për vlerësimin e efektivitetit të reagimit gjyqësor ndaj krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”

Prishtinë, 5 qershor 2024

Anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorise së Apelit, Arian Gashi dhe Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, morën pjesë në prezantimin e Raportit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), me titull: “Nga letra në praktikë – vlerësimi i efektivitetit të reagimit gjyqësor ndaj krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”. Që të dy ishin në cilësinë e panelistëve, me ç’rast janë përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve.

Në këtë publikim ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë së vendit, me ç’rast u diskutuan gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raportit, i cili ka për qëllim t’i ndihmojë institucionet relevante në adresimin e mangësive të identifikuara në ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të rënda të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmes ofrimit të rekomandimeve praktike të bazuara në gjetjet nga monitorimi i proceseve gjyqësore nga ana e projektit.



Në përmbyllje të takimit të sotëm u tha se është thelbësor bashkëpunimi i sistemit të drejtësisë dhe organizatave ndërkombëtare siç është OSBE-ja, për adresimin e sfidave dhe përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit në sistemi prokurorial dhe gjyqësor.



Mbahet testi me shkrim për kandidatë për prokurorë të rinj të shtetit

Prishtinë, 9 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka organizuar mbajtjen e testit me shkrim, në kuadër të procesit të rekrutimit të njëzetekatër (24) prokurorëve të rinj të shtetit, i cili u mbajt në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.



Në testin me shkrim morën pjesë 281 kandidatë, prej tyre 150 meshkuj dhe 131 femra, prej të cilëve dy janë pjesëtarë nga radhët e minoriteve.

Kryesuesi i Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, Blerim Isufaj, së bashku me anëtarët e tjerë, ka mbikëqyrë rrjedhën e mbajtjes së testit me shkrim.





Ky proces u zhvillua edhe nën mbikëqyrjen e monitoruesve të EULEX-it dhe OSBE-së.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do t'ju mbajë të informuar me kohë për rrjedhën e procesit të mëtejshëm.

Betohet anëtari i ri i Këshillit Prokurorial nga radhët e Odës së Avokatëve të Kosovës

Prishtinë, 18 qershor 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti takimin e 249-të.

Në fillim të takimit ka dhënë betimin anëtari i ri joprokuror i Këshillit Prokurorial nga radhët e Odës së Avokatëve të Kosovës, Mustafë Nuhiu, i cili është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, me ç'rast Kryesuesi Hajdaraj i uroi mirëseardhje, duke i dëshiruar punë të suksesshme në mandatin e tij. Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli Prokurorial I Kosovës:

- Miratoi raportet përfundimtare të vlerësimit për përmbushjen e trajnimit fillestar për prokurorët e shtetit të gjeneratës së dhjetë dhe vendimin e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Miratoi Raportin vjetor të punës për vitin 2023 të Komisionit Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit strategjik dhe Planit të veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, së bashku me një rekomandim të anëtarëve të KPK-së;



- Miratoi Rregulloren për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Prokurorial, së bashku me shtojcat përkatëse;
- Miratoi Rregulloren për Planifikimin e Personelit, së bashku me shtojcat përkatëse;
- Miratoi Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial të Kosovës;
- Miratoi Kërkesën Buxhetore për vitin 2025 dhe Vlerësimet e Hershme për vitet 2026-2027;
- Formoi një grup punues për hartimin e raportit që do të përmbajë analizën dhe rekomandimet për rishikimin e skemës së kompensimit;
- Formoi një grup punues për shqyrtimin e mundësisë së përfshirjes së anëtarëve joprokurorë në komisionet e KPK-së;
- Aprovoi propozimet për publikimin e vendimeve disiplinore nga autoritetet kompetente dhe për publikimin e vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës për Vlerësim të Performancës;
- Mbajti seancë dëgjimore lidhur me rastin disiplinor ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ndërsa vendimi do të bëhet publik sipas ligjeve në fuqi.



Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 19 qershor 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë përveç anëtarëve të Komisionit për Administrimin e Prokurorive të KPK-së dhe Grupit punues për përgatitjen e Raportit analitik për mënyrën e trajtimit të rasteve me kryerës të panjohur (PPP), i kryesuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Admir Shala, edhe përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Projekti CEPEJ, si dhe zyrtarët e Departamentit të Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KPK-së dhe të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.



Me këtë rast, pjesëmarrësit në këtë takim diskutuan për të dhënat statistikore që përmban ky raport lidhur me rastet nga regjistri PPP, pastaj për analizën procedurale-ligjore për trajtimin e rasteve nga regjistri PPP dhe rekomandimet e prezantuara.

Ky raport është prezantuar në aspektin narrativ dhe tabelar, në të cilin figuronin të dhënat nga prokuroritë e vendit, kurse në analizën procedurale-ligjore për trajtimin e rasteve nga regjistri PPP, është theksuar se sa i përket aspektit ligjor dhe procedural, trajtimi i këtyre rasteve me kryes të panjohur paraqet një sfidë në regjistrat e sistemit prokurorial.

Përfaqësuesit e institucioneve prokuroriale, gjyqësore dhe të Akademisë së Drejtësisë të Kosovës takohen me Sekretarin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë së Gjermanisë

Prishtinë, 20 qershor 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj dhe Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, u takuan sot me Sekretarin Shtetëror të Ministrisë së Drejtësisë së Federatës Gjermane, Benjamin Strasser.

Në takim morën pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i Fondacionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), Stefan Hülshörster, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë së Federatës Gjermane, Piotr Maladionski dhe përfaqësuesi i Ambasadës së Federatës Gjermane në Kosovë, Sebastian Leuschner, me bashkëpunëtorët e tyre. Gjatë këtij takimi janë diskutuar objektivat dhe prioritetet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, me fokus në reformën në drejtësi, sundimin e ligjit dhe fuqizimin e profesioneve të lira.

Përfaqësuesit e institucioneve kosovare shprehën mirënjohjen e tyre për mbështetjen e vazhdueshme të Federatës Gjermane dhe veçanërisht të IRZ-së në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Sekretari Strasser falënderoi institucionet kosovare për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.



Mbahet punëtori për prezantimin e Draftregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës të Administratës së Sistemit Prokurorial

Prishtinë, 21 qershor 2024

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga prokurori Armend Zenelaj, i mbështetur nga OSBE-ja, ka organizuar një punëtori për prezantimin e draftit të Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës të Administratës së Sistemit Prokurorial.



Në këtë punëtori morën pjesë Zëvendëskryesuesja e KPK-së, anëtarë të KPK-së, anëtarë të komisioneve të përhershme dhe grupit punues, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe Drejtori i NJSHPP-së, përfaqësues të administratës së sistemit prokurorial, ZMNV-së dhe OSBE-së. Në këtë punëtori janë trajtuar kategoritë funksionale, klasat, emërtimet e pozitive për çdo klasë, grupet e administrimit të veçantë, përshkrimet të përgjithshëm, rregullat, standardet dhe metodologjia për vlerësimin e klasifikimit të pozitivave të punës në një klasë apo një grupi të caktuar në administratën e sistemit prokurorial. Gjithashtu, në fokus të sesioneve të kësaj punëtorie dyditore ishte edhe shqyrtimi i kategorive funksionale të pozitivave në administratën e sistemit prokurorial, përshkrimi i përgjithshëm i punës për kategorinë e lartë drejtuese, për kategorinë e mesme drejtuese dhe kategoritë e tjera, kompetencat për vlerësimin e klasifikimit të pozitivave të punës dhe procedurat e vlerësimit dhe miratimit të klasifikimit. Ky draft I rregullores do të dërgohet për finalizim në Komisionin për Çështje Normative dhe do të procedohet për miratim në Këshillin Prokurorial.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së mban takimin me administratorët e prokurorive të vendit

Prishtinë, 25 qershor 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK), Sami Istrefi, ka mbajtur takimin me administratorët e prokurorive të vendit.



sistematike të zbatimit të obligimeve në bazë të mandateve të administratorëve të prokurorive të vendit, pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Funkionimin e Prokurorit të Shtetit.

Gjithashtu në këtë takim, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, trajtoi e çështjet e nivelit të sigurisë nëpër objektet e prokurorive të vendit, si dhe njoftoi administratorët për procesin e hartimit finalizimit të akteve të brendshme, të cilat rregullojnë statusin e stafit administrativë në sistemin prokurorial.

Drejtori Istrefi, nënvizoi në fund të takimit se, administratorët do të kenë përkrahjen e tij, kurse përkushtimi dhe angazhimi i shtuar i tyre do të krijojë mundësi reale për rritjen e efikasitetit dhe avancimin e mëtejshëm të administrimit të prokurorive të vendit.

Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 25 qershor 2024

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë përveç anëtarëve të tij, edhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, EUKOJUST-it, UNDP-së dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.



Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për draftimin e Rregullore për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit.

Me këtë rast, Kryesuesi i Komisionit për Çështje Normative, Armend Zeneli, theksoi se kjo rregullore do të draftohet mbi bazën e parimeve, standardeve dhe praktikave më të mira evropiane, si dhe falënderoi përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë në Kosovë për mbështetjen dhe ofrimin e ekspertizën së tyre për një akt kaq të rëndësishëm të sistemit prokurorial.

Mbahet punëtori për prezantimin e perspektivës reformuese të sistemit prokurorial

Prishtinë, 27 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) në bashkëpunim me OSBE-në në Kosovë, organizoi një punëtori dyditore në Tiranë, në të cilën morën pjesë Kryesuesi i Këshilli Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, anëtarë të KPK-së, prokurorë të ZKPSH-së, kryeprokurorë, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Drejtoresha e NJSHPP-së, përfaqësues të OSBE-së dhe zyrtarë të administratës së sistemit prokurorial.



sidomos me fokus të veçantë në realizmin e barazisë gjinore dhe integrimin e komuniteteve.

Në sesionin e ditës së parë folën Kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi dhe përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Mark Lasser, të cilët theksuan rolin dhe rëndësinë e madhe të zbatimit të barazisë gjinore dhe integritit të pjesëtarëve të komuniteteve në sistemin e drejtësisë. “Jemi të vetëdijshëm që me një angazhim të përbashkët në sistemin e drejtësisë mund të arrijmë rezultate të qëndrueshme në kuadër të arritjes së barazisë gjinore dhe integritit të pjesëtarëve të komuniteteve në Kosovë”, tha më këtë rast Kryesuesi Hajdaraj.



Po ashtu në këtë punëtori pati diskutime edhe për sfidat e integritit të të rinjve nga radhët e komuniteteve, si dhe për përdorimin e gjuhëve dhe sfidat e përkthimit në seancat gjyqësore, me ç'rast pjesëmarrësit u pajtuan që të ketë intensifikim të angazhimeve të përbashkëta për këto çështje që u diskutuan për dy ditë me radhë, sepse është nevojë e kohës që të ketë progres të mëtejshëm në rrugën përpara.